

Prof. dr. Musa KRAJA

MEDITIME RRETH LIBRIT “SHPALIME ETNOPEDAGOGJIKE ” I PROF. DR. SHEFIK OSMANI

Një vepër e përmasave madhore vjen për të gjithë lexuesit shqiptar dhe për të gjithë ata që kërkojnë të dinë më tepër rreth mënyrës së edukimit të brezit të ri.

Vëllimi i dytë i botimit “Shpalime etnopedagogjike” Tiranë 2008, i profesorit të njour Shefik Osmani, na jep një panoramë retrospektive të mendimit pedagogjik shqiptar. Kjo ka bërë të mundur që para lexuesit të kalojnë figura të shquara të kombit, si për çështjen kombëtare, ashtu edhe për hapejn e shkollave dhe mësimin e gjuhës shqipe, e më gjerë.

Duke qëmtuar me kujdesin e studjuesit të mirëfilltë, autori ka ditur të nxjerrë në pah vllerat e vecanta, që na përcillen nga veprat e tyre të shquara. Pa hyrë në hollësi aty njohim kontributin e Barletit për edukimin patriotik e ushtarak, P. Bogdani gjithçka që lidhet me kujdesin për gjuhën shqipe, për anën profesionale të saj, N.Vequlharxhi për nevojën e arsimit e të edukimit të brezit të ri, K. Kristoforidhi me kujdesin për shkronjat shqipe dhe për fjalët e thella që ai qëmton nga gjuha e popullit dhe vargu i këtyre dishepujve e patriotëve të lëvizjes arsimore për zgjimin e vetëdijes kombëtare. Dhe për mësimin dhe këndimin e libra në shqip. Janë 40 figura të tilla, ku prof. Osmani ka nxjerrë në pah ato vlera që sollën secili prej tyre, por edhe për ato ngjarje e kongrese kombëtare që e ngritën fort zërin për gjuhën shqipe.

Në një mbledhje të rëndësishme me intelektualë e përfaqësues nga tërë hapësira shqiptare, u trajtuan si temë “Familjet e mëdha”, duke pasur si kryefjalë familjen e Kastriotëve, vlerat e Gjergj Kastriot Skënderbeut, duke u dhënë përgjigje njëkohësisht edhe

një apo disa zërave të jashtëm a të brendshëm, që përpiqen të çmitizojnë disa personalitete, kolosë të kombit, duke filluar nga Heroi ynë Kombëtar, i afirmuar në Historiografinë Botërore, atyre, që të nisur nga motive jo të qarta, ose qëllimdashëse, kanë hedhur ndonjë tymnajë, ndaj këtij personaliteti epokal kombëtar, me vlera zonale, evropiane e më gjerë. Pikëpamjet “pluraliste” të “mendimit të lirë”, për të justifikuar këto zëra të shkëputur, nuk kanë baza, as mbështetje, përkundrazi.

Duke meditar, si qytetar, pa pretenduar në ndonjë mënyrë paralelizmi përsa po shkruaj më poshtë, mendja më shkon në optikën time arsimore, ku unë kam bindjen dhe idealin tim profesional. Mendja më shkoi te “Familjet arsimore”, jo aq të dëgjua, por që ekzistojnë objektivisht, të përbëra nga 3 apo 10 mësues, disa prej të cilëve të shquar në zonë, qytet apo në tërë vendin, familje të cilat i gjejmë në Tiranë, Elbasan, Shkodër, Gjirokastrë, Vlorë, Berat, Tetovë, Prishtinë, Gjakovë etj., të cilat përbëjnë vlera të vërteta kombëtare për arsimin, shkollën e mendimin pedagogjik në formimin e brezëve të reja.

Një nga këto familje është ajo e mësuesit veteran Ethem Osmani, i njohur dhe i nderuar në Shkodër, për veprimtari konkrete në arsim, i nderuar pas vdekjes me titullin “Mësues i Popullit”. Në shtëpinë e mësuesit pasionant e atdhetar lindën fëmijët Shefik, Nezihë dhe Tomorr Osmani, që të tre mësues të shquar, që e lidhën jetën e tyre në punë të pandërprerë për arsimin e shkollën shqipe, prej të cilëve dy profesorë të nderuar: Shefik dhe Tomori. Edhe gratë e tyre, të të dy vëllezërve, u bënë mësuese të vlerësuara lart nga opinioni shoqëror dhe arsimor, nga të cilat Urtia, zonja e Shefikut, “Mësuese e Popullit”, edhe kjo e ardhur nga një familje arsimore e nderuar libohovite.

Vepra “Shpalosje etnopedagogjike” paraqet veprimtarinë e mbi 30 personaliteteve të njohur, megjithëkëtë, libri nuk duhet parë me syrin e 60, 70 apo 80-vjeçarëve, që i kanë njohur ose kanë lexuar për traditën shqiptare. Disa portrete në mënyrë të sintetizuar janë edhe në fjalorin pedagogjik të profesorit, të cilin e botoi kur ishte kandidat i shkencave (vetëm me atë vepër mund të merrte doktoraturën e merituar), por në vepër janë paraqitur me specifika veprimtarië, krijimtarië, personalitete të shquara të arsimit shqiptar të viteve ‘30 të shekullit të kaluar e deri në mesin

e atij shekulli.

Keto personalitete, si vazhdim i vëllimit të parë me të njëjtin emër, janë sistemuar në bazë kriteresh profesionale. Sigurisht, vetë numri i madh i tyre, të le të kuptosh se secili është trajtuar në mënyrë të sintetizuar, me synim për të dhënë argumente konkrete, se mësues dhe personalitete të shkollës shqiptare nuk i kanë munguar këtij vendi, madje me vlera të larta shkencore, me njohje të thelluara pedagogjike, psikologjike, me formim të lartë gjuhësor, letrar, me ndjenja dhe pasione të thelluara progresiste e frytdhënëse për brezat që kanë kaluar.

Autori fillon me M. Barletin, në dy fusha të rëndësishme edukimi: edukimi patriotik dhe edukimi ushtarak, vazhdon me P. Bogdanin, gjithashtu në dy çështje: "Të punuarit përpara letrarisht, - Udhëzime për të lexuar drejt në gjuhën shqipe. - shkallëzimi i moshave sipas Bogdanit dhe - Dy nga figurat e Cuneusit, që shërbyen si mjete konkretizimi, - Të marrët e Diellit, - Të marrët e Hanesse.

Te periodizimi i moshave të Bogdanit, duke nënvizuar se edhe pse autori nuk është larg nga baza historike e Komenskit, pedagogut të nivelit botëror, i cili mes të tjerash, u mor edhe me periodizimin e moshave, del se periodizimi i Bogdanit është origjinal, pa e çuar "në dyer të tjera", por duke respektuar edhe origjinalitetin e Bogdanit.

Edhe pse janë botuar libra të veçantë nga autorë të ndryshëm për personalitete si N. Veqilharxhi, K. Kristoforidhi, Z. Jubani, S. Frashëri, A. Kullurioti, J. Vreto, S. Qiriazhi, L. Gurakuqi, H. Mosi, N. Lako, P. N. Luarasi, autori ka bërë interpretime të tjera, ka sistemuar të dhënat bashkë me informacione të reja, në këndvështrimet e autorit, duke i shoqëruar edhe me të dhëna të tjera për ngjarje të rëndësishme arsimore. Të tilla janë "Lidhja Shqiptare e Prizrenit" (1878-1881), f. 68-74, "Kongresi i Manastirit", f. 166-171, "Kongresi Kombëtar për Problemet e Arsimit" (1909), f. 184-187, Kongresi II i Manastirit, (1910), f. 188-194, duke vazhduar edhe me ngjarje pas Pavarësisë, si "Qeveria e Përkohshme e Vlorës", f. 226-228, "Kongresi Arsimor i Lushnjës" (1920), "Kongresi Arsimor i Tiranës" (1922), f. 332-333, "Kongresi Arsimor Kombëtar" (1924), f. 354-356 etj.

Duke vazhduar me personalitete të tjera të arsimit e të shkollës

shqipe, autori vazhdon të sjellë të dhëna dhe portretizime të S. Pecit, duke e paraqitur me "Shkollat shqip - Roli i mësonjësit në botë të sotme"; A. Xhuvani përmes "Na duhen libra, edukata në familje e në shkollë, edukata fizike, mendore, estetike, morale, qytetare, edukata për punën, edukata kombëtare etj.; Shtjefen Gjeçovi me pjesët: Shoqëria, gjuha e mësonjëtorëve t' Shqiprisë të jote gjuha shqipe..., pastaj me Mingën, Siliqin, S. Çekën, P. Qriazin, G. Beltojën, M. Logorecin, U. Rumbon, Z. Harapin, K. Kamsin, Th. Avramin, S. Shuteriqin, S. Pappariston, Kole Koçin, V. Vinjën, duke e mbyllur me Q. Guranjakun.

Siç shihet, përfshihet një periudhë e gjatë, 1508-1939, duke i paraprirë çdo personaliteti me një ese që evidenton vlerat pedagogjike, didaktike, psikologjike, arsimore, duke shënuar dhe të dhëna biografike. Autori ndjek kritere mbi vendosjen e materialeve. Vepra shoqërohet me bibliografi të pasur për traditën shqiptare në fushën e arsimit, të shkollës e të personaliteteve, që kanë bërë emër në këtë sektor tepër të rëndësishëm, me rrezatime në të gjithë segmentet e jetës shqiptare. Nënvizohen organet e shumta, me 29 revista, duke filluar nga "Drita", "Dituria", 1884-1885, Kostandinopojë, e deri tek Revista Pedagogjike e vitit 1990, me 30 gazeta, duke filluar nga "Shqipëria" në Bukuresht, 1897, e deri tek "Drita", Tiranë 1939.

Me këtë botim krijohen vizione të përgjithshme për studentë, mësues e të interesuar të tjerë në këto fusha. Duke sjellë pjesëza apo fragmente të veprave nxitet me tej interesimi për studiuesit. Të tilla janë p.sh: "Arsimi përbën shtyllën e qytetërimit të vërtetë", e Sami Frashërit, apo "Gjuha shqip" dhe "Për arsimin dhe edukatën", Jani Vreto etj.

E rëndësishme është se këtu nuk bëhet biografi personalitetesh, por jepen të dhëna në fushën e studimeve dhe botimeve pedagogjike, çka i bind me argumente lexuesit, se shumë probleme didaktike, pedagogjike, udhëzime, etj. janë bërë me kohë, se ato duhen njohur, pasi përbëjnë vlera në mendimin pedagogjik shqiptar.